

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2011
- Statusi Ligjor: Organizatë joqeveritare
- Selia Qendrore: Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: <https://irca.al/>
- Email kryesor i organizatës: institute.irca@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 696187840

2. Misioni

Misioni i IRCAs është mbrojtja e të drejtave e njeriut, me fokus komunitetin rom, si një nga grupet më të marginalizuara, me qëllim fuqizimin e tyre dhe rritjen e aksesit në shërbime, si dhe krijimin e një rrjeti që angazhohet për përfshirje sociale, barazi gjinore, sfidim stereotipesh, mbrojtje mjedisi, trashëgimie kulturore etj, për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe që bazohet në diversitet.

3. Vizioni (Opsionale)

IRCA synon të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme, ku komunitetet rome dhe grupet e marginalizuara janë të fuqizuara socialisht, ekonomikisht dhe kulturash, të orientuara drejt përfshirjes sociale dhe aftësive digjitale, dhe resiliente ndaj sfidave bashkëkohore si ndryshimet klimatike, pabarazitë gjinore dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm, edukimit mjedisor, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, IRCA synon të krijojë hapësira dhe mundësi drejt përfshirjes, barazisë dhe mirëqenies për të gjithë.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

Fushat kryesore ku IRCA operon janë si në vijim:

1. Fuqizimi institucional- Forcimi i kapaciteteve të stafit në koordinimin e projekteve, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, sigurimin e fondeve dhe zhvillimin e dokumenteve e politikave të brendshme, me qëllim përmirësimin e efikasitetit organizativ. IRCA synon të integrojë qasjet për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndjeshmëri mjedisore në të gjitha aspektet e menaxhimit institucional.

2. Angazhim ndërkulturor- Nxitja e përfshirjes dhe krijimi i marrëdhënieve midis individëve me background të ndryshëm kulturor dhe socio-ekonomik, si dhe angazhimi për ruajtjen dhe promovimin e kulturës. IRCA thekson respektin për diversitetin kulturor dhe krijimin e një mjedisi mbështetës që vlerëson dallimet. Kjo gjithashtu nënkupton edukimin ndërkulturor mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në komunitetet e marginalizuara dhe promovimin e të drejtave mjedisore.

3. Fuqizimi i të rinjve-Pajisja e të rinjve me aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për t'u bërë agentë ndryshimi në komunitetet e tyre dhe më gjerë. Programet për të rinjtë përfshijnë gjithashtu ngritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike, si dhe nxitjen e aktivizmit të gjelbër përmes iniciativave rinore në mbrojtje të natyrës.

4. Advokimi dhe pjesëmarrja qytetare- Zbatimi i programeve që u mundësojnë qytetarëve romë dhe joromë të avokojnë për ndryshime në politikat dhe proceset publike. Kjo punë fokusohet në fuqizimin e komuniteteve, promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje. IRCA përfshin në këtë qasje edhe advokimin për

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

politika mjedisore të drejta dhe gjithëpërfshirëse, që adresojnë në mënyrë të veçantë ndikimin e krizave klimatike tek grupet e cënueshme.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

IRCA punon aktivisht në një sërë programesh të ndara në disa kategori:

1. Programet e Bashkimit European, ku IRCA është në rolin e koordinatorit ose partnerit kombëtar dhe ose/ndërkombëtar
2. Programe globale
3. Programe me fokus shkëmbimin kultur dhe identifikimin e praktikave pozitive
4. Programe të financuara nga donatorë të huaj, ambasada ose agjenci të huaja që operojnë në vendin tonë
5. Programe të financuar në formën e subgranteve dhe/ ose partnershipit me organizatat që operojnë në Shqipëri
6. Programe të financuara nga strukturat e qeverisjes lokale dhe/ose qëndrore

Të gjitha programet janë të lidhura ngushtësisht me misionin e IRCAs.

6. Shtrirja Gjeografike

IRCA operon në të gjithë Shqipërinë, duke qënë një organizatë lidere në zbatimin e projekteve në të gjitha bashkitë.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Bledar Taho

Bordi i Drejtuesve: Sebastjan Hamzaj, Saimir Kazanxhiu, Robert Azemi

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

IRCA ka zhvilluar partneritete të forta me një sërë aktorësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Partnerët dhe donatorët kryesorë përfshijnë agjenci të Kombeve të Bashkuara si UNDP, UNICEF, UNHCR, UNFPA, IOM dhe ILO, me të cilat IRCA ka bashkëpunuar në projekte për përfshirje sociale, mbështetje për refugjatët dhe fuqizim ekonomik. Organizata ka përfituar gjithashtu nga mbështetja e vazhdueshme financiare e Bashkimit European dhe Komisionit European, përmes programeve si ROMACTED dhe ERASMUS+, duke kontribuar në integrimin e romëve dhe fuqizimin e të rinjve. IRCA është pjesë aktive e rrjeteve të rëndësishme si European Roma Institute for Arts and Culture (ERAC), IRIS Netëork, si dhe ka krijuar partneritete afatgjata me institucione ndërkombëtare si Universiteti Clemson dhe Fondacioni Anna Lindh. Gjithashtu, bashkëpunimi me ambasada të ndryshme në Shqipëri ka qënë thelbësor për realizimin e projekteve me ndikim në nivel lokal dhe rajonal.

9. Ndikimi

Me mbështetjen e **Allianz Foundation** dhe në partneritet me **Associazione di Promozione Sociale Giallo Sassi**, IRCA ka udhëhequr zbatimin e projektit "**Fuqizimi i të Rinjve Shqiptarë dhe Italianë për të Mbështetur Komunitetet në Nevojë në Përballjen me Ndryshimet Klimatike përmes Artit dhe Kulturës (REACT)**". Qëllimi kryesor i projektit ishte forcimi i reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe transformimi i jetës së komuniteteve përmes fuqizimit të të rinjve përmes një programi ndërkombëtar edukimi me bazë artin dhe kulturën. Projekti arriti me sukses krijimin e **Akademisë për Ambasadorët e Klimës**, duke trajnuar **40 të rinj nga Shqipëria dhe Italia** si agentë ndryshimi në adresimin e ndikimeve të klimës në komunitetet vulnerabël. U organizuan **10 leksione të hapura "Climate Talk"** në shkolla dhe universitete, duke nxitur dialog mbi efektet e ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjet e mundshme. Iniciativa përfshiu gjithashtu **konkursë artistike, ekspozita në Matera dhe Tiranë**, ditë pune në komunitet për gjelbërimin e hapësirave, si dhe **takime me qeveritë vendore** për të advokuar për masa konkrete në rritjen e reziliencës klimatike. Projekti prodhoi edhe një **dokumentar mbi pasojat e ndryshimeve klimatike** dhe u përmbyll me evente të fuqishme përmbyllëse në Tiranë dhe Matera, ku u bashkuan të rinj, aktivistë dhe qytetarë për të promovuar veprimet për klimën.



Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

IRCA është një organizatë shumë aktive dhe të gjitha zhvillimet e fundit i pasqyron në mediat sociale si më poshtë: [Web](#) ; [Instagram](#); [Facebook](#) dhe [Youtube](#).

Gjithashtu, për më shumë info, ju ftojme të lexoni [Raporti Vjetor 2024](#).

-